

20252484839

МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА

Në bazë të nenit 52, paragrafit (4) të Ligjit për Arsimin Profesional dhe Trajnimin (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 3/25 dhe 74/25), ministri i Arsimit dhe Shkencës, solli

R R E G U L L O R E **PËR STRUKTURËN, ORGANIZIMIN DHE MËNYRËN E REALIZIMIT TË** **PROVIMIT SPECIALIZUES NË FUND TË ARSIMIT POST - TË MESËM**

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet struktura, organizimi dhe mënyra e realizimit të provimit specializues në fund të arsimit post - të mesëm.

Neni 2

Provimi specializues jepet pas përfundimit të arsimit post - të mesëm specializues dhe përbën kontroll përfundimtar të njohurive, aftësive dhe kompetencave të fituara, në përputhje me kualifikimet e Kornizës së Kualifikimeve të Maqedonisë.

Për nënshtrimin e provimit specializues, kandidati aplikon duke parashtruar aplikimin në institucionin për arsimin specializues (në tekstin e mëtejme: institucioni), të paktën 30 ditë para fillimit të periudhës së provimit.

Në aplikimin e paragrafit 2 të këtij neni, kandidati thekson nëse do t'i nënshtrohet provimit të plotë ose pjesë të provimit.

Neni 3

Provimi specializues realizohet në të paktën tre periudha provimesh gjatë vitit shkollor.

Nga ana e institucionit, në fillim të vitit shkollor përcaktohen afatet e provimeve dhe ato shpallen në tabelën e njoftimeve dhe/ose në ueb-qafen e institucionit.

Neni 4

Programi i provimit specializues përgatitet për çdo kualifikim nga arsimi specializues dhe ai përmban udhëzime të detajuara për organizimin dhe realizimin e pjesëve të provimit specializues të përshkruara në nenin 7 të kësaj rregulloreje.

Neni 5

Nga ana e drejtorit të institucionit formohet komisioni i provimeve, i cili e realizon provimin specializues.

Komisioni i provimit, nga paragrafi 1 i këtij neni, është përbërë nga tre anëtarë dhe zëvendësuesit e tyre, dhe atë:

Kryetar – zëvendëskryetar mësimdhënës me të paktën pesë vjet përvojë pune në fushën përkatëse,

Anëtar – zëvendësanëtar mësimdhënës për lëndët profesionale nga sektori përkatës,

Anëtar – zëvendësanëtar përfaqësues nga radhët e partnerëve socialë me të cilët institucioni ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi ose këshilltar nga Qendra për Zhvillimin e Arsimit Profesional.

Neni 6

Nga ana e komisionit të provimit realizohen:

- organizimi dhe ndjekja e realizimit të provimit specializues në përputhje me programin e provimit;
- sigurimi i kushteve për realizimin e pjesës teoriko-profesionale dhe pjesës praktike;
- verifikim i njohurive, aftësive dhe kompetencave të kandidatëve;
- realizimi i vlerësimit sipas kriterëve të përcaktuara në programin e provimit;
- mbajtja e procesverbalit për zhvillimin dhe rezultatet e provimit specializues;
- sigurimi i objektivitetit, paanësisë dhe besueshmërisë në vlerësim dhe
- përgatitja e raportit për rezultatet e provimit specializues dhe dorëzimi tek personi përgjegjës për arsimin post - të mesëm në institucion.

Neni 7

Provimi specializues përbëhet nga dy pjesë, dhe atë:

Pjesa teoriko-profesionale – kontrollimi i njohurive teorike sipas programit të provimit dhe

Pjesa praktike – kontrollimi i aftësive për përgatitjen dhe/ose realizimin e detyrës praktike.

Neni 8

Pjesa teoriko-profesionale dhe praktike e provimit specializuese mund të realizohen në të njëjtën ditë ose në ditë të ndryshme në kuadër të një afati të provimit.

Neni 9

Pjesa profesionale-teorike e provimit specializues realizohet në institucion.

Pjesa praktike e provimit specializues mund të realizohet në institucion, në kompaninë ku kandidati ka përfunduar praktikën specializuese ose në organizatë tjetër që plotëson kërkesat për dhënien e pjesës praktike të provimit specializues.

Neni 10

Për secilën pjesë të provimit specializues jepet notë e veçantë.

Rezultatet e provimit specializues publikohen më së voni tre ditë nga dita e përfundimit të provimit specializues.

Kandidati që nuk ka kaluar një ose dy pjesë të provimit specializues mund t'i nënshtrohet atyre në afatin e ardhshëm të provimit.

Neni 11

Për kandidatët me vështirësi bëhet përshtatja e provimit specializues sipas llojit të vështirësisë: vështirësi intelektuale, fizike, shqisore, siç është koha e zgjatur për dhënien e provimit specializues, sigurimi i asistentit personal ose interpretues i gjuhës së shenjave.

Për kandidatët me vështirësi auditive, detyrat dhe udhëzimet jepen me shkrim dhe vizualisht.

Për kandidatët me vështirësi vizuale, detyrat dhe udhëzimet jepen me shkrim me alfabetit e Brajtit, fond të zmadhuar ose në formë audio.

Gjatë dhënies së provimit specializues, mund të përdoret edhe teknologjia asistuese: ekran i Brajtit, aplikacione zanore, sinjalistikë, tabela të adaptuara, etj.

Neni 12

Për secilin kandidat mbahet procesverbal që përmban: emrin dhe mbiemrin, pjesët e provimit specializues, notat e marra dhe firmat e anëtarëve të komisionit të provimit.

Neni 13

Rezultatet përfundimtare të provimit specializues për kandidatët që e kanë kaluar provimin specializues, regjistrohen në librin kryesor për provimin specializues.

Neni 14

Me ditën e fillimit të zbatimit të kësaj rregulloreje, pushon së vlefshmi Rregullorja për strukturën, organizimin dhe mënyrën e realizimit të provimit specializues (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 135/17).

Neni 15

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme pas ditës së publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe do të fillojë të zbatohet nga viti shkollor 2026/2027.

Nr. 18-15279/1
5.12.2025
Shkup

Ministre e Arsimit
dhe Shkencës,
Prof. Dr. **Весна Јаневска**, d.v.